



# “PËRMBUSHJA” E PREMTIMIT PËR SINJALIZUESIT





Autorë: Arrita Reznici dhe Florian Smajli

Me kontribut të veçantë nga: Flamur Kabashi dhe Anesa Hoxha

Ekipi redaktues: Ehat Miftaraj, Betim Musliu, Gzim Shala

Asnjë pjesë e këtij materiali nuk mund të shtypet, kopjohet apo riprodhohet në çfarëdo lloj forme, elektronike apo të shtypur, ose në çfarëdo forme tjetër riprodhimi pa lejen e Institutit të Kosovës për Drejtësi.

*Ky publikim u hartua nga Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) brenda projektit "Përmbushja e Premtimit të Sinjalizimit – Mbrojtja e të Drejtave të Qytetarëve dhe Parandalimi i Korrupsionit", financuar nga Balkan Trust for Democracy, një projekt i "German Marshall Fund" të Shteteve të Bashkuara dhe USAID. Mendimet e shprehura në këtë raport nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht ato të Balkan Trust for Democracy, German Marshall Fund të SHBA-së, USAID, ose Qeverisë së SHBA-së.*

RRETH IKD-së

Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) është një organizatë joqeveritare dhe jofitimprurëse e politikave publike, një tank i të menduarit i specializuar në sektorin e drejtësisë.

IKD

Rruga: Ilaz Agushi, nr. 146, Prishtinë

E: [info@kli-ks.org](mailto:info@kli-ks.org)

[www.kli-ks.org](http://www.kli-ks.org)

Me përkrahje të:



Tetor, 2024

Prishtinë, Republika e Kosovës



## Contents

1. Përmbledhje ekzekutive.....	7
2. Hyrje .....	9
3. Ligji për mbrojtjen e sinjalizuesve dhe institucioni publik përgjegjës .....	10
4. Vështrim i përgjithshëm i të dhënave mbi zbatimin e ligjit për mbrojtjen e sinjalizuesve ...	11
4.1. Sinjalizimi i jashtëm.....	12
4.2. Sinjalizimi i brendshëm.....	15
5. Sfidat në zbatimin e Ligjit për Mbrojtjen e Sinjalizuesve .....	22
6. Gjetjet kyçe dhe përfundimet.....	24
7. Rekomandimet .....	25

**Lista e shkurtesave:**

**APK** – *Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit*

**IKD** – *Instituti i Kosovës për Drejtësi*

**KPK** – *Këshilli Prokurorial i Kosovës*

**QKUK** – *Qendra e Klinike Universitare e Kosovës*

**OJQ** – *Organizata Jo – Qeveritare*

**KGjK** – *Këshilli Gjyqësor i Kosovës*

**MINT** – *Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë*

## 1. Përmbledhje ekzekutive

Ligji për Mbrojtjen e Sinjalizuesve lidhur me sektorin publik hyri në fuqi në janar të vitit 2019. Një vit më vonë ky ligj filloi zbatimin edhe në sektorin privat. Pavarësisht se është vlerësuar si një ligj që përafrohet me praktikën më të mira ndërkombëtare, zbatimi i tij në praktikë pothuajse është i pavërtetshëm duke mos arritur qëllimin për të cilin është miratuar. Kjo bazohet edhe në faktin se edhe pesë vite që kur ka filluar zbatimi i të njejtit ende nuk ka pasur një rast konkret të suksesshëm të sinjalizimit që do të shërbente si shembull për rëndësinë e këtij ligji. Sikurse, ka raporte shqetësuese për hakmarrje ndaj sinjalizuesve në rastet kur të njejtit kanë guximin personal dhe profesional për të raportuar shkeljet në sektorin publik apo atë privat.

Ligji me qëllim të parandalimit dhe luftimit të korrupsionit në sektorin publik dhe privat ka paraparë tre lloje të sinjalizimeve: të brendshme (tek punëdhënësi i tyre), të jashtme (tek një autoritet përkatës), ose publike (nëpërmjet mediave, OJQ-ve, platformave online, takimeve, etj). Statistikat tregojnë se numri i raporteve të sinjalizimeve të jashtme dhe të brendshme vazhdojnë të rriten vit pas viti.

Sipas të dhënave të analizuara nga raportet vjetore të APK-së, nga viti 2020 deri në vitin 2023, ka pasur 54 raportime sinjalizuese të jashtme dhe 304 raportime sinjalizuese të brendshme. Prej tyre, 136 raportime janë regjistruar në QKUK brenda një viti (2020), por për këtë institucion, nuk është regjistruar asnjë rast sinjalizues viteve pasuese.

Edhe përkundër se ligji ofron mbrojtje për sinjalizuesit, mbeten akoma shumë sfida në zbatimin e tij. Nga diskutimet e zhvilluara në fokus grupin e organizuar për këto çështje, u mësua se Ligji i ri për APK-në, kufizon veprimet e agjencisë në rastet e sinjalizimeve të jashtme. U theksua se APK nuk ka më kompetencë të kryej hetime paraprake për rastet e raportuara tek ata, me përjashtim të çështjeve që lidhen me deklarimet e pasurisë, dhuratat dhe konfliktet e interesit.

Sfida të tjera që ndikojnë në numrin e ulët të rasteve të sinjalizimit përfshijnë çështjet që kanë të bëjnë me përzgjedhjen e zyrtarëve përgjegjës për pranimin dhe trajtimin e rasteve të sinjalizimit brenda institucioneve publike. Konkretisht, duket se disa institucione nuk e kuptojnë plotësisht rëndësinë e emërimit të këtyre zyrtarëve, duke çuar kështu në zbrazëtira kohore ndërmjet shkarkimit të zyrtarit të mëparshëm dhe emërimit të zyrtarit pasues. Gjithashtu, u theksua edhe çështja e ruajtjes së dosjeve të sinjalizimeve gjatë periudhës ndërmjet shkarkimit të një zyrtari dhe përzgjedhjes së zyrtarit pasues.

Mungesa e kuptimit të rëndësisë së kësaj procedure bën që institucionet të neglizhojnë informimin e stafit të tyre për procedurën e sinjalizimit dhe se kujt do të duhej t'i raportojnë këto raste. Në disa situata, stafi nuk informohet as për ndryshimin e zyrtarit përgjegjës për pranimin dhe trajtimin e këtyre rasteve. Kjo mund të çojë në situata ku raportimet u bëhen individëve të cilët nuk janë kompetentë.

Një nga çështjet më problematike është frika e hakmarrjes nga punëdhënësit, siç shihet edhe në një rast madhor ku është përfshirë edhe vetë kryeministri Kurti. Në këtë rast, sinjalizuesi u pezullua, duke dërguar kështu një mesazh mjaft kërcënues për sinjalizuesit potencial.

E gjithë kjo e bën të vështirë eliminimin e pasigurisë dhe frikës nga hakmarrja mes sinjalizuesve.



## 2. Hyrje

Në shoqëritë të cilat janë të udhëhequra nga parimet e sundimit të ligjit dhe qeverisjes së mirë, sinjalizuesit në sektorin publik shihen si vlerë dhe aset i rëndësishëm për mbrojtjen e interesit publik. Sinjalizuesit në sektorin publik të cilët raportojnë dhe ekspozojnë shkeljet dhe problemet kyçe brenda institucioneve, mund të konsiderohen si heronj mes zyrtarëve publik me integritet me qëllim të ruajtjes së interesit publik dhe vlerave të cilat janë të garantuara me ligjet e aplikueshme.

Kosova ka një kornizë ligjore për mbrojtjen e sinjalizuesve që nga viti 2011 me Ligjin për Mbrojtjen e Informatorëve.<sup>1</sup> Ky ligj nuk ofronte mbrojtjen e duhur për sinjalizuesit dhe as një sistem të saktë raportimi. Pas kësaj, në vitin 2019 Kosova miratoi një ligj të ri, përkatësisht Ligjin për Mbrojtjen e Sinjalizuesve,<sup>2</sup> i cili trajton disa situata të parregulluara lidhur me mbrojtjen e sinjalizuesve.

Ligji aktual parasheh të drejta dhe mbrojtje të sinjalizuesve, llojet e sinjalizimeve, mbrojtjen gjyqësore, dispozitat për kundërvajtje dhe raportimin vjetor. Për më tepër, ligji ka rregulluar domosdoshmërinë e konfidencialitetit, si dhe procedurën dhe autoritetet kompetente. Gjithashtu, Ligji ka dispozita specifike edhe për sektorin privat.

Po ashtu, ekziston edhe një akt nënligjor, përkatësisht Rregullorja për Përcaktimin e Procedurës për Pranimin dhe Trajtimin e Rasteve të Sinjalizimit,<sup>3</sup> që parasheh rregullat dhe procedurat për trajtimin e një rasti të sinjalizimit, si dhe përgjegjësitë e zyrtarit përgjegjës.

Pavarësisht kornizës ligjore dhe akteve nënligjore shtesë, në Kosovë sfida më e madhe mbetet zbatimi i tyre në praktikë. Kur kanë kaluar pesë vite e nëntë muaj nga hyrja në fuqi e këtij ligji në sektorin publik, ende nuk është raportuar një rast i suksesshëm i sinjalizimit, përmes së cilit është promovuar sundimi i ligjit, qeverisja e mirë apo ruajtja e buxhetit të shtetit. Për më tepër, duke pasur parasysh vetë faktin se për periudhën kohore midis viteve 2020 – 2023, numri i rasteve të raportuara nuk është edhe aq i madh, mund të konstatohet se nuk ka ndërgjegjësim të mjaftueshëm për këtë ligj apo se zyrtarët publik nuk kanë besim të mjaftueshëm në institucionet përkatëse për të raportuar shkeljet potenciale të ligjit.

Në mënyrë që të ketë një pasqyrë të saktë të situatës së sinjalizimit në vend, Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) në këtë raport ka përdorur analiza cilësore të të dhënave, duke kombinuar një rishikim të kornizës ligjore, raporteve të institucioneve shtetërore, si dhe njohurive nga publikimet e OShC-ve. Po ashtu, IKD ka përdorur metodën kuantitative duke përdorur të dhëna statistikore të mbledhura nga raportet. Gjithashtu, IKD organizoi një fokus grup me palët kryesore të interesit të përfshira në sinjalizim dhe mbrojtjen e sinjalizuesve. Në këtë fokus grup morën pjesë përfaqësues dhe zyrtarë përgjegjës për sinjalizimin nga institucionet publike, përfaqësues nga niveli lokal,

---

<sup>1</sup> Ligji Nr. 04/L-043 për Mbrojtjen e Informatorëve (2011).

<sup>2</sup> Ligji Nr. 06/L-085 për Mbrojtjen e Sinjalizuesve (2018).

<sup>3</sup> Rregullore (GRK) - Nr. 03/ 2021 Për Përcaktimin e Procedurës për Pranimin dhe Trajtimin e Rasteve të Sinjalizimit (2021).

avokatë dhe përfaqësues nga OJQ-të dhe mediat. E gjitha kjo synonte të ofronte pasqyrimin sa më të saktë të situatës aktuale lidhur me sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve në Kosovë.

### 3. Ligji për mbrojtjen e sinjalizuesve dhe institucioni publik përgjegjës

Nëpërmjet kornizës ligjore që është në fuqi, Kosova ka arritur të ndërtojë një sistem për raportimin apo sinjalizimin e shkeljeve të caktuara në sektorin publik dhe privat. Ligji për Mbrojtjen e Sinjalizuesve përcakton rregullat për raportimin e keqbërjeve, duke përfshirë procesin, mbrojtjen e sinjalizuesve dhe përgjegjësitë e institucioneve kompetente.<sup>4</sup> Sipas Ligjit për Mbrojtjen e Sinjalizuesve, individët kanë mundësi të raportojnë për shkeljet që janë kryer, janë aktualisht në vazhdim, ose që ka gjasa të arsyeshme të ndodhin në të ardhmen.<sup>5</sup>

Ligji i lartpërmendur ofron tre mundësi për raportimin e keqbërjeve: brenda (tek punëdhënësi i tyre), jashtë (tek një autoritet përkatës) ose publikisht (nëpërmjet mediave, OJQ-ve, platformave online, takimeve, etj).<sup>6</sup>

Çdo metodë ka procedurën e vet, por që të gjitha kërkojnë informacion të qartë dhe gjithëpërfshirës, duke përfshirë detaje dhe të dhëna specifike. Sinjalizuesit mund të raportojnë me shkrim, me postë ose email, apo edhe verbalisht.

Për sa i përket sinjalizimit të brendshëm, është e nevojshme të dihet se ligji ofron parimet mbi të cilat duhet të emërohet zyrtari përgjegjës brenda institucionit publik apo privat. Ligji parasheh që një institucion publik që ka më shumë se pesëmbëdhjetë (15) të punësuar ose ai privat që ka më shumë se pesëdhjetë (50) punonjës është i detyruar të caktojë një zyrtar përgjegjës, në mënyrë që të trajtoj nga brenda rastet e sinjalizimit. Ndërkohë, Rregullorja për Procedurat e Sinjalizimit përcakton një kornizë transparente për marrjen, hetimin dhe adresimin e raportimeve për keqbërje. Për më tepër, ai mbron sinjalizuesit dhe specifikon detyrat e zyrtarit përgjegjës.<sup>7</sup>

Ligji parashikon afate ligjore për rastet e sinjalizimit. Për shembull, në rastet kur kemi të bëjmë me sinjalizim të brendshëm, punëdhënësi është i detyruar të njoftojë sinjalizuesin brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nëse raportimi i tij/saj është pranuar apo refuzuar, ndërsa procedura e hetimit pas marrjes së sinjalizimit nuk mund të zgjasë më shumë se dyzet e pesë (45) ditë, përveç kur rrethanat e rastit kërkojnë vazhdimin e afatit, i cili nuk mund të kalojë dyzet e pesë (45) ditë.<sup>8</sup>

Duhet të dihet se sinjalizimi i brendshëm është gjithmonë një opsion. Ndërsa, sinjalizimi i jashtëm vlen për situatat kur dikush ka provuar raportimin e brendshëm, por është i pakënaqur me përgjigjen, ose nëse dikush nuk ndihet rehat për të raportuar nga brenda (p.sh. frika nga hakmarrja). Në Kosovë, APK është përgjegjëse për zbatimin e Ligjit për Mbrojtjen e Sinjalizuesve. Në fushën e mbrojtjes së sinjalizuesve, APK është po ashtu institucioni që trajton rastet e sinjalizimit të

---

<sup>4</sup> Ligji për Mbrojtjen e Sinjalizuesve; Neni 2.

<sup>5</sup> Po aty; Neni 5.

<sup>6</sup> Po aty; Neni 13.

<sup>7</sup> Rregullorja për Përcaktimin e Procedurës për Pranimin dhe Trajtimin e Rasteve të Sinjalizimit; Neni 1.

<sup>8</sup> Ligji për Mbrojtjen e Sinjalizuesve, Neni 16.

jashtëm. Përveç kësaj fushe, APK është përgjegjëse për zbatimin e Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik dhe Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave. Po ashtu, APK është përgjegjëse edhe për ndërmarrjen e veprimeve në fushën e monitorimit të planit të veprimit të strategjisë nacionale kundër korrupsionit, vlerësimit kundër- korrupsion të akteve ligjore, vlerësimeve të rrezikut të korrupsionit dhe planeve të integritetit.<sup>9</sup>

Sipas Ligjit, APK-ja ka përgjegjësi të ndjek procedurat për sinjalizimin e jashtëm, ndërsa në rastet kur APK-ja konstaton se nuk është kompetente për të trajtuar çështjen, ia përcjell me shpejtësi organit kompetent dhe sipas ligjit, siguron mbrojtjen e identitetit të sinjalizuesit, duke kërkuar miratim nga i njëjti nëse dëshiron t'ia përcjell informacionin me identitet të plotë autoritetit kompetent apo jo.<sup>10</sup>

Nga ana tjetër, punonjësit e subjekteve private duhet t'i drejtojnë raportet e sinjalizimeve të jashtme tek Inspektorati i Punës, organi i autorizuar për trajtimin e rasteve të tilla.

Krahas procedurës administrative, ligji ka parashikuar edhe mbrojtje gjyqësore për sinjalizuesit. Në raste të tilla, ligji parashikon që nëse dikush sinjalizon keqëbërjen dhe përjeton hakmarrje, ai (dhe kushdo i afërt i tij që është dëmtuar gjithashtu) ka të drejtë të shkojë drejtpërdrejt në gjykatë për mbrojtje. Ata nuk kanë nevojë të kalojnë nëpër të gjitha hapat e mjeteve të brendshme juridike në procedurën administrative. Padia kundër veprës së dëmshme parashtrohet brenda gjashtë (6) muajve nga dita kur sinjalizuesi është njoftuar, por jo më vonë se tre (3) vjet kur është kryer vepra e dëmshme.<sup>11</sup>

#### **4. Vështrim i përgjithshëm i të dhënave mbi zbatimin e ligjit për mbrojtjen e sinjalizuesve**

Raporti vjetor i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit zbulon se që nga viti 2019 APK ka trajtuar gjithsej 54 raste të sinjalizimeve të jashtme. Megjithatë, të dhënat tregojnë se numri i rasteve është rritur çdo vit.

Ndërkohë, për sinjalizimin e brendshëm, bazuar në raportet vjetore të APK-së, shihet se janë 304 raste të raportuara në total. Numri më i madh i rasteve të sinjalizimeve të brendshme është regjistruar në vitin 2020, me gjithsej 146 raste. Megjithatë, në këtë rast, statistikatat nuk japin një pasqyrim gjithëpërfshirës, pasi 93% e atyre rasteve të sinjalizimit, apo 136, janë bërë brenda një institucioni të vetëm, QKUK. Kështu, të gjitha institucionet e tjera, përveç QKUK, kanë dorëzuar vetëm 10 raporte të brendshme. Për më tepër, përkundër numrit të lartë të rasteve të sinjalizimit në QKUK gjatë vitit 2020, asnjë rast i sinjalizimit nuk është gjetur në vitet pasuese.

<sup>9</sup> Ligji nr. 08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit; Neni 5.

<sup>10</sup> Ligji për Mbrojtjen e Sinjalizuesve; Neni 11 dhe 18.

<sup>11</sup> Po aty; Neni 24.

Në vitin 2021 ka pasur rritje të numrit të rasteve të sinjalizimit të brendshëm (duke mos përfshirë situatën me QKUK-në në vitin 2020), me 38 raste të raportuara për atë vit.

Në gjysmën e parë të vitit 2022,<sup>12</sup> 36 raste kanë qenë aktive, dhe në vitin 2023, numri total i rasteve të sinjalizimeve të brendshme ishte 84.

#### 4.1. Sinjalizimi i jashtëm

APK në vitin 2019 është marrë informacion për 3 raste të sinjalizimeve të jashtme, të cilat të gjitha janë refuzuar.<sup>13</sup> Sipas sqarimeve të dhëna në raport, rasti i parë thuhet se është refuzuar pasi meqenëse informacioni është trajtuar si sinjalizim i brendshëm, dhe është konstatuar konsumimi i veprave penale, atëherë institucioni që ka përcjellë informacionin është dashur të njoftojë organin kompetent dhe të mos dërgoj informacionin më tej në APK.<sup>14</sup> Për rastin e dytë, sipas të dhënave të APK-së dhe vlerësimit të dhënë, informacioni nuk përbën një raport kërcënimi apo shkelje të interesit publik.<sup>15</sup> Ndërsa rasti i tretë u refuzua, pasi sipas vlerësimit të APK-së, fillimisht duhet trajtuar brenda institucionit nëpërmjet sinjalizimit të brendshëm, si dhe u vlerësua se nuk përbën kallëzim për kërcënim apo shkelje të interesit publik.<sup>16</sup>

Lidhur me rastet e vitit 2020, APK ka marrë informacion për 5 raste të sinjalizimit të jashtëm. Prej të cilave, 4 janë refuzuar dhe 1 është mbyllur<sup>17</sup>. Rasti i parë u refuzua për disa arsye, fillimisht thuhet se sinjalizuesi është njoftuar për rezultatin e hetimit për njërin rast, ndërsa për tjetrin është njoftuar se është ende në procedurë hetimore administrative. Ndër të tjera, ky rast përfshinte edhe pretendime për veprime të dëmshme, të kryera ndaj sinjalizuesit si rezultat i raportimit të tij<sup>18</sup>. Lidhur me këtë pretendim, APK-ja në raportin e saj ka arritur në përfundimin se këto masa të ndërmarra kundër sinjalizuesit vijnë si rezultat i sinjalizimeve të tyre. Tre raste të tjera, u refuzuan me arsyetimin se informacioni duhet të trajtohej fillimisht brenda institucionit, nëpërmjet sinjalizuesit të brendshëm ose direkt në APK. Ndërkaq një rast tjetër, është mbyllur sepse, siç thuhet në raportin e APK-së, nuk plotëson kërkesat që duhet të përmbajë një sinjalizim<sup>19</sup>.

Për vitin 2021, janë marrë informacione edhe për 9 raste të sinjalizimit të jashtëm. Nga këto, 2 janë refuzuar, 3 janë mbyllur dhe 1 është pushuar. Kurse, për 3 raste të tjera APK-ja deklaroi se janë në proces e sipër<sup>20</sup>. Rasti i parë u refuzua me arsyetimin se agjencia kishte marrë më parë informacion

---

<sup>12</sup> Shënim: Gjysma e dytë e vitit 2022 nuk është përfshirë në këtë përmbledhje pasi nuk është paraqitur në raportin vjetor të APK-së për atë vit. Ndërkohë, të dhënat e paraqitura në raportin vjetor të APK-së për 2022 dhe 2023 nuk japin informacion të detajuar për rastet e sinjalizimit të brendshëm të këtyre viteve.

<sup>13</sup> Agjencia Kundër Korrupsionit, “Raporti Vjetor i Punës 2019”, f. 16.

<sup>14</sup> Ibid.

<sup>15</sup> Po aty.

<sup>16</sup> Po aty.

<sup>17</sup> Po aty, fq. 16-17

<sup>18</sup> Po aty.

<sup>19</sup> Po aty, fq. 17.

<sup>20</sup> Agjencia kundër Korrupsionit, “Raporti Vjetor i Punës 2021”, fq. 21. ([https://www.akk-ks.org/assets/cms/uploads/files/Publikimet/RAPOTI%20VJETOR%20I%20PUNES-AKK-2021%20\(1\)](https://www.akk-ks.org/assets/cms/uploads/files/Publikimet/RAPOTI%20VJETOR%20I%20PUNES-AKK-2021%20(1))).

për subjektin në lidhje me keqpërdorimin e pozitës zyrtare dhe se i njëjti ishte trajtuar më parë nga agjencia në kuadër të kompetencave ligjore për procedurën paraprake hetimore<sup>21</sup>. Për tre raste të tjera, APK njoftoi se ato ishin mbyllur nga agjencia me arsyetimin se nuk kishte prova të mjaftueshme për të mbështetur dyshimin e arsyeshëm për shkeljet e supozuara ligjore<sup>22</sup>. Një rast tjetër, përfshin pretendimet për veprime hakmarrëse kundër sinjalizuesit për shkak të sinjalizimit që ata kishin bërë. Ky rast u refuzua me arsyetimin se agjencia nuk kishte arritur të vërtetonte se masat e ndërmarra nga institucioni, ishin në fakt veprime hakmarrëse, apo masa të lidhura me rastin që ka raportuar subjekti<sup>23</sup>. Një rast tjetër, u pushua duke u bazuar në informacionin e dhënë nga një sinjalizues, se ky rast po trajtohet brenda institucionit përgjegjës dhe se është në proces hetimor<sup>24</sup>. Ndërkaq, për tre raste të tjera është raportuar që ishin në vazhdim të procedurës gjatë asaj kohe<sup>25</sup>.

Në vitin 2022, APK-ja ka raportuar se ka trajtuar gjithsej 14 raste të reja, po ashtu edhe 3 raste të tjera të cilat kanë qenë të transferuar nga viti i kaluar.

Njëri nga këto raste, pas procedurës së raportimit të jashtëm të APK-së, është përcjellë si informacion në Prokurori. Një rast tjetër është dërguar si kërkesë për procedim të mëtutjeshëm nga organi kompetent. Rasti tjetër i është dërguar Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Kundërvajtje si kërkesë për fillimin e procedurës për kundërvajtje, pasi që është vlerësuar se ka prova të mjaftueshme për të mbështetur dyshimin e arsyeshëm për mosrespektimin e obligimeve që dalin nga dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Sinjalizuesve duke kryer kështu kundërvajtje. Një rast tjetër, është dërguar si kërkesë për procedurë të mëtutjeshme në organin kompetent<sup>26</sup>.

Katër raste janë refuzuar, sepse APK-ja ka konsideruar se subjekti i sinjalizimit nuk ka respektuar procedurën – në një rast thuhet që subjekti ka shfrytëzuar sinjalizimin publik, pa ndjekur më parë sinjalizimin e brendshëm apo të jashtëm. Lidhur me rastet e refuzuara, sipas vlerësimit të APK-së, rasti duhej të ishte trajtuar fillimisht brenda institucionit, nëpërmjet sinjalizimit të brendshëm. Në dy raste të tjera, APK konsideroi se raportimi duhet të ishte trajtuar fillimisht si sinjalizues i brendshëm. Një tjetër rast është refuzuar për shkak se APK ka vlerësuar se informacioni nuk përbën një raport, i cili mbrohet nga Ligji për Mbrojtjen e Sinjalizuesve<sup>27</sup>.

---

<sup>21</sup> Po aty.

<sup>22</sup> Po aty.

<sup>23</sup> Po aty.

<sup>24</sup> Po aty.

<sup>25</sup> Po aty, fq. 22.

<sup>26</sup> Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, “Raporti Vjetor i Punës 2022”, fq. 46 (<https://www.aks.org/assets/cms/uploads/files/2023/RAPORTI%20VJETOR-2022-SHQIP.pdf>)

<sup>27</sup> Po aty.

Për më tepër, dy raste të tjera u refuzuan nga APK me arsyetimin se të njëjtat raste nuk bien në kuadër të kompetencave të saj<sup>28</sup>.

Në bazë të raportit të APK-së, thuhet se janë edhe shtatë raste të cilat janë mbyllur. Tre prej tyre u mbyllën, pasi që APK-ja konstatoi se raportimi i bërë për rastin nuk përbën shkelje ligjore. Në një rast tjetër, APK-ja ka konstatuar se nuk ka pretendime konkrete, në bazë të të cilave do mundësohej që rasti të trajtohet si sinjalizim jashtëm. Për më tepër, dy raste janë mbyllur, pasi që APK-ja nuk ka mundur të konfirmojë të gjitha informacionet/të dhënat e nevojshme që pritej të plotësoheshin nga sinjalizuesi<sup>29</sup>.

Gjatë vitit 2023 APK ka trajtuar gjithsej 20 raste, prej të cilave 18 janë përfunduar, ndërsa 2 janë në vazhdim. Prej tyre, dy raste i janë përcjellë si informacion Prokurorisë. Ndërsa, dy raste të tjera janë përcjellë si kërkesë për procedim të mëtutjeshëm nga organi kompetent<sup>30</sup>.

Në ndërkohë, janë refuzuar edhe 14 raste të tjera. Në një rast, APK-ja konsideroi se raportimi nuk e cenon interesin publik. Në një rast tjetër, APK konsideroi se raportimi duhet të ishte trajtuar fillimisht si një sinjalizim i brendshëm. Një rast është refuzuar për shkak se APK ka konsideruar se raportimi mund të trajtohet nga departamentet përkatëse brenda Agjencisë, përmes procedurave ligjore. Shtatë nga këto raste janë refuzuar për shkak se APK-ja nuk ka mundur të konfirmojë të gjitha informacionet/të dhënat e nevojshme që pritej të plotësoheshin nga sinjalizuesi. Tri raste janë refuzuar pasi APK-ja vlerësoi se raportimi nuk përbën shkelje siç parashihet me ligji. Po ashtu një rast është refuzuar nga agjencia me arsyetimin se informatat e rastit i tejkalojnë kompetencat ligjore të agjencisë për të trajtuar rastin dhe se tashmë rasti është duke u hetuar nga Prokuroria e Shtetit<sup>31</sup>.



**Grafiku 1. Numri i rasteve të sinjalizimeve të jashtme gjatë viteve 2020-2023.**

<sup>28</sup> Po aty.

<sup>29</sup> Po aty, fq. 42-43.

<sup>30</sup> Po aty, fq. 43.

<sup>31</sup> Po aty, fq. 43.

Për më tepër, IKD gjen se numri i rasteve për sinjalizim të jashtëm ka vazhduar të rritet edhe këtë vit. Bazuar në diskutimet e grupeve të fokusit, rezulton se numri i rasteve të sinjalizimit të jashtëm vetëm në gjysmën e parë të këtij viti (2024) duket të jetë më i lartë se numri total i rasteve nga viti i kaluar (2023). Andaj, numri i rasteve të sinjalizimit të jashtëm vazhdon të rritet vit pas viti.

Mirëpo, nga diskutimet e mbajtura në fokus grupin e organizuar për këto raste, u zbulua se Ligji i ri për APK-në kufizon veprimet e agjencisë në rastet e sinjalizimit të jashtëm. Tutje, u theksua se në këtë ligj theksohet se APK-ja nuk ka më autoritet të kryejë hetime paraprake për rastet e raportuara, me përjashtim të çështjeve që lidhen me deklarimin e pasurisë, dhuratat dhe konfliktin e interesit.

Megjithatë, IKD gjen se nuk duket të ketë ndonjë pengesë ligjore që e pengon APK të kryejë hetime administrative në rastet e sinjalizimit të jashtëm. Neni 17.1 i Ligjit për APK-në thotë se “Agjencia zhvillon procedurën e hetimit administrativ në rastet që bien në mandatin e saj:”. Po ashtu, sipas nenit 5.1 pika 1.1 të po këtij ligji, thotë se Agjencia është përgjegjëse, ndër të tjera, për zbatimin e Ligjit për Mbrojtjen e Sinjalizuesve. Mbikëqyrja dhe marrja e masave të nevojshme për mbrojtjen e sinjalizuesve është një nga kompetencat e APK-së. Natyrisht, kur rastet e raportuara nuk janë në mandatin e APK-së, atëherë njoftohen institucionet kompetente.

#### 4.2. Sinjalizimi i brendshëm

Në raportin e saj, APK-ja paraqet të dhënat për sinjalizimin e brendshëm. Kjo vjen si kërkesë e Ligjit për Mbrojtjen e Sinjalizuesve, i cili parasheh detyrimin e zyrtarëve përgjegjës, përkatësisht obligimin e institucioneve që të raportojnë në APK për numrin e rasteve që kanë pranuar për vitin paraprak.

Në lidhje me këtë, për vitin 2019 APK-ja njoftoi se janë raportuar vetëm 2 raste, të cilat janë paraqitur në tabelën e mëposhtme:<sup>32</sup>

	Institucioni	Numri i rasteve	Veprimet e ndërmarra
1	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor	2	Rasti I – është informuar autoriteti kompetent; Rasti II – është në fazën e hetimit administrativ, rrjedhimisht duke u zhvilluar brenda afatit ligjor.

**Tabela 1: Rastet e sinjalizimit të brendshëm për vitin 2019 në institucionet publike.**

<sup>32</sup> Agjencia kundër Korrupsionit, “Raporti Vjetor i Punës 2019”, fq. 17, ([https://www.akk-ks.org/assets/cms/uploads/files/Publikimet/Raporte/01.%20Raporti\\_Vjetor\\_i\\_Punes\\_AKK\\_viti\\_2019\\_ver\\_final\\_Shqip\\_AKK\\_Mars\\_2020.pdf](https://www.akk-ks.org/assets/cms/uploads/files/Publikimet/Raporte/01.%20Raporti_Vjetor_i_Punes_AKK_viti_2019_ver_final_Shqip_AKK_Mars_2020.pdf)).

Në vitin 2020, APK njoftoi se ishin raportuara 146 raste si sinjalizime të brendshme brenda institucioneve, të cilat janë paraqitur në tabelën e mëposhtme:<sup>33</sup>

	Institucioni	Numri i rasteve	Veprimet e ndërmarra
1	Qendra Klinike Universitare e Kosovës	136	Nuk kemi asnjë informacion i cili sqaron lidhur me veprimet e ndërmarra nga QKUK-ja lidhur me këto raste, edhe pse është kërkuar sqarim.
2	Universiteti “Ukshin Hoti”, Prizren	2	Rasti I është mbyllur për shkak të mungesave të provave; Rasti II - është nën hetim.
3	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit	1	Pas kryerjes së hetimeve administrative, është përpiluar një raport, i cili i është përcjellë Sekretarit të MKRS-së për veprime të mëtutjeshme.
4	Ministria e Punëve të Brendshme	1	I është dorëzuar punëdhënësit me një raport me rekomandimet që duhet të zbatohen.
5	Agjencia e Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale	1	Rasti është në procedurë hetimore.
6	Komuna e Gjakovës	1	Rasti ka përfunduar, është njoftuar organi kompetent.

<sup>33</sup> Agjencia kundër Korrupsionit, “Raporti Vjetor i Punës 2019”, ([https://www.akk-ks.org/assets/cms/uploads/files/Publikimet/Raporte/3.%20Raporti\\_Vjetor\\_AKK\\_2020\\_Shqip.pdf](https://www.akk-ks.org/assets/cms/uploads/files/Publikimet/Raporte/3.%20Raporti_Vjetor_AKK_2020_Shqip.pdf)).



7	Operator Sistemi, Transmisioni dhe Tregu	1	Çështja i është përcjellë punëdhënësit dhe APK-së.
8	Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë	1	Është dorëzuar një raport për shkelje disiplinore.
9	Ministria e Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor	2	Rasti I ka përfunduar brenda afatit ligjor; Rasti II i është sjellë në vëmendje autoritetit kompetent.

**Tabela 2: Rastet e sinjalizimit të brendshëm për vitin 2020 në institucionet publike.**

Sipas raportit vjetor të punës së APK-së për vitin 2020, rezulton se nga raportet e institucioneve publike të marra në APK për atë vit, janë trajtuar gjithsej 146 raste të sinjalizimit të brendshëm. Nga këto raste, institucionet publike kanë mbyllur një (1) rast, dy (2) raste kanë pasur procedurë hetimore, tre (3) raste i kanë referuar në AKK ndërsa për 140 rastet e mbetura janë ndërmarë veprime të tjera.

Rastet në total	Refuzuar/Mbyllur	Nën hetim	Referuar AKK	Veprime të tjera të ndërmarra
146	1	2	3	140

**Tabela 3. Zgjidhja e rasteve të sinjalizimit të brendshëm në vitin 2020.**

Ndërkaq, gjatë vitit 2021 APK ka njoftuar se 38 raste janë raportuar si sinjalizim i brendshëm brenda institucioneve dhe i ka paraqitur si në tabelën e mëposhtme.<sup>34</sup>

Institucioni	Numri i rasteve	Veprimet e ndërmarra
1 Zyra e Kryeministrit të Republikës së Kosovës	3	<p>Rasti I është trajtuar në bashkëpunim me zyrtarin përgjegjës për mbrojtjen e sinjalizuesve në Sekretariatit e Këshillit të Sigurisë së Kosovës – Qendra e Situatave, rasti ishte i mbyllur dhe i gjithë dokumentacioni është dorëzuar në zyrën e Sekretarit të SKSK-së për përpunim të mëtutjeshëm.</p> <p>Rasti II është pranuar që të trajtohet, por përkundër këmbënguljes përmes shkresave për takim dhe trajtim të rastit, nga pala parashtruese nuk ka pasur përgjigje për të vazhduar më tej me procedurat, kështu që lënda ka mbetur e papërfunduar.</p> <p>Rasti III është në procedurë hetimore administrative.</p>
2 Sekretariati i Këshillit të Sigurisë së Kosovës	1	Është trajtuar brenda afateve ligjore.
3 Universiteti “Ukshin Hoti” Prizren	1	Rasti është mbyllur, janë dhënë rekomandimet.
4 Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural	4	Asnjë nga kërkesat nuk ishin pranuar, pasi supozohej që ky rast duhej t'i drejtohej institucioneve të tjera, sinjalizuesi u këshillua t'ia drejtonte

<sup>34</sup> Agjencia kundër Korrupsionit, “Raporti Vjetor i Punës 2021”, fq. 21. ([https://www.akk-ks.org/assets/cms/uploads/files/Publikimet/RAPOTI%20VJETOR%20I%20PUNES-AKK-2021%20\(1\)](https://www.akk-ks.org/assets/cms/uploads/files/Publikimet/RAPOTI%20VJETOR%20I%20PUNES-AKK-2021%20(1))).

			kërkesën zyrtarit përgjegjës të institucionit të tij.
5	Ministria e Drejtësisë	7	<p>Tri raste janë refuzuar për shkak të mungesës së kompetencës dhe referimit të ligjit nga LPS; Dy raste janë pranuar si raporte me interes publik, por gjatë hetimit administrativ është vlerësuar se nuk plotësojnë kriteret ligjore për t'u trajtuar në bazë të LPS;</p> <p>Një rast është hetuar dhe ka përfunduar, në të cilin është konstatuar se ka të bëjë me cenimin e interesit publik. Për këtë janë informuar sinjalizuesi, punëdhënësi dhe organi kompetent;</p> <p>Një rast është pranuar pjesërisht dhe është në fazën e hetimit administrativ.</p>
6	Ministria e Punëve të Brendshme	2	<p>Rasti I është trajtuar</p> <p>Rasti II është në procedurë hetimore</p>
7	Ministria e Shëndetësisë	2	<p>Të dy rastet e sinjalizuesve u gjetën me bazë ligjore</p> <p>Zyra ka ndërmarrë masat e nevojshme në përputhje me LMS-në , duke marrë masa të menjëherëshme për të parandaluar vazhdimin e çdo veprimi të dëmshëm nga praktikantët e përdorura</p>
8	Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë	3	Nuk ka kompetencë për ta trajtuar

9	Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore	1	Rasti ka kaluar tek organi kompetent
10	Agjencia Kosovare e Privatizimit	1	Sinjalizimi është gjetur si i bazuar. Pohimet e sinjalizuesit janë verifikuar, ndërsa AKP-ja ka marrë masa parandaluese lidhur me shkeljet e adresuara.
11	Sekretariati i Këshillit Prokurorial të Kosovës	1	Informacione shtesë u kërkuan nga sinjalizuesi në lidhje me pretendimin e tij, por nga ana e të njëjtit nuk është marrë asnjë përgjigje lidhur me këtë rast.
12	Korporata Energjetike e Kosovës	9	Janë trajtuar nëntë raste të sinjalizimit, për të cilat janë përgatitur nëntë raporte nga zyrtari përgjegjës për sinjalizim.  Në këto raporte janë dhënë rekomandime për përmirësimin e procesit të punës, inicimin e masave disiplinore, gjithashtu disa nga këto raste janë në shqyrtim, pasi që duhet vlerë suar nëse ka elemente të veprës penale, e të procedohet më tej tek organet kompetente.
13	Operator Sistemi, Transmisioni dhe Tregu	3	Rasti I është përfunduar, raporti përfundimtar është dërguar edhe në APK;  Rasti II, ish-zyrtari përgjegjës për sinjalizim i ka kërkuar Kryeshefit Ekzekutiv që të urdhërojë një inspektim profesional në mënyrë që rasti në fjalë

			<p>të shqyrtohet dhe të nxirren përfundime të sakta;</p> <p>Rasti III, ish-zyrtari përgjegjës për sinjalizimin ua ka përcjellë personave kompetentë të cilëve u është drejtuar letra, por për këtë rast ende nuk ka asnjë reagim.</p>
--	--	--	---

**Tabela 4: Rastet e sinjalizimit të brendshëm për vitin 2021 në institucionet publike.**


Në raportin vjetor të APK-së për vitin 2021, thuhet se institucionet kanë raportuar gjithsej 38 raste të sinjalizimeve të brendshme. Nga këto raste 13 janë refuzuar/mbyllur, tre kanë qenë në procedurë hetimore, katër janë referuar në AKK dhe veprime të tjera janë ndërmarrë në 18 raste.

<b>Totali i rasteve</b>	<b>Të refuzuara/mbyllura</b>	<b>Nën procedurë hetimore</b>	<b>Të referuara në AKK</b>	<b>Veprime të tjera të ndërmarra</b>
<b>38</b>	<b>13</b>	<b>3</b>	<b>4</b>	<b>18</b>

**Tabela 5: Zgjidhja e Rasteve të Sinjalizimit të Brendshëm në vitin 2021.**

Nga ana tjetër, një pasqyrë kaq e detajuar e rasteve të sinjalizimit nuk ishte dhënë në raportet e APK-së për vitin 2022 dhe 2023. Ndryshe nga vitet e mëparshme, raportet për 2022-2023 tregojnë vetëm natyrën e sinjalizuesve. Për më tepër, në raportin e punës së APK-së për vitin 2022, të dhënat jepen vetëm për gjysmën e parë të atij viti.

Raporti i APK-së për vitin 2022 vë në dukje se gjatë gjysmës së parë të 2022, janë trajtuar 36 raste nën sinjalizim të brendshëm, ku 21 nga reporterët ishin meshkuj dhe 10 femra. Ndërkaq, për vitin 2023, thuhet se janë trajtuar 84 raste nga institucionet publike, ku 51 sinjalizues janë identifikuar meshkuj, 22 femra dhe 11 të tjerë kanë qenë sinjalizues anonim. Raporti thekson se nga 180 institucione publike për të cilat Agjencia ka informacione për zyrtarin përgjegjës të caktuar për sinjalizimin, 51 institucione publike nuk e kanë dorëzuar raportin e sinjalizimit për gjashtëmuajorin e parë në APK, ndërsa 129 institucione e kanë dorëzuar raportin.



**Grafiku 2. Numri i rasteve të Sinjalizimit të Brendshëm gjatë viteve 2020-2023.**

Duke pasur parasysh rritjen e vazhdueshme të rasteve të sinjalizimeve të brendshme, diskutimi në fokus grup preku edhe faktorët që mund të ndikojnë pozitivisht në këtë aspekt. Nga ky diskutim, një nga faktorët kryesorë u tha se ishte informimi adekuat i personelit nga ana e zyrtarit përgjegjës për sinjalizimin, se ku dhe si të raportohej. Një faktor tjetër ishte përgjegjësia e zyrtarit të sinjalizimit në ruajtjen e konfidencialitetit të sinjalizuesit, duke rritur kështu nivelin e besimit midis stafit. Po ashtu, një faktor tjetër shumë i rëndësishëm del të jetë qëndrimi i palëkundur i zyrtarit ndaj kërcënimeve, presioneve apo përpjekjeve tjera për të ndërhyrë në trajtimin e rasteve të sinjalizimit.

## **5. Sfidat në zbatimin e Ligjit për Mbrojtjen e Sinjalizuesve**

Një prej pikave kryesore të diskutimit në fokus grup ishin sfidat në zbatimin e Ligjit për Mbrojtjen e Sinjalizuesve. Një nga këto sfida, që pengon zbatimin e këtij ligji, u tha se ishte edhe Ligji i ri për APK. U theksua se çështja qëndron në faktin se Ligji për Mbrojtjen e Sinjalizuesve flet se si APK-ja kryen hetime vetëm në bazë të kompetencave të saj, kompetenca këto të cilat janë të kufizuara me Ligjin e ri për APK-në. Si rezultat, APK-ja tani mund të kryejë hetime paraprake vetëm nëse denoncimi ka të bëjë me konflikte interesi ose çështje që lidhen me deklarin e pasurisë dhe dhuratave. Megjithatë, IKD gjen se nuk duket të ketë ndonjë pengesë ligjore që e pengon APK-në të kryejë hetime administrative në rastet e sinjalizimit të jashtëm. Neni 17.1 i Ligjit për APK-në thotë se “Agjencia zhvillon procedurën e hetimit administrativ në rastet që bien në mandatin e saj”. Po ashtu, sipas nenit 5.1 pika 1.1 të po këtij ligji, thotë se Agjencia është përgjegjëse, ndër të tjera, për zbatimin e Ligjit për Mbrojtjen e Sinjalizuesve. Mbikëqyrja dhe marrja e masave të nevojshme për mbrojtjen e sinjalizuesve është një nga kompetencat e APK-së. Natyrisht, në rastet kur rastet e raportuara nuk janë në mandatin e APK-së, njoftohen institucionet kompetente.

Për më tepër, një sfidë tjetër e mundshme e përmendur ishte numri i zyrtarëve të APK-së që trajtojnë rastet e sinjalizimit.

Si sifidë tjetër që u përmend në këtë diskutim ishte edhe fakti se mbrojtja e sinjalizuesve ofrohet përmes gjykatave dhe bëhet tejzgjatje e procedurave gjyqësore.

Gjatë diskutimeve në këtë fokus grup, u ngritën shqetësime edhe për emërimin e zyrtarëve përgjegjës për sinjalizimin në institucionet publike. Këto shqetësime u ngritën nga këndvështrime të ndryshme, një prej të cilave ishte niveli i besimit që stafi ka tek zyrtari i emëruar.

Një çështje e rëndësishme është emërimi i zyrtarëve të sinjalizimit, ku janë dhënë shembuj se si individëve të profesioneve të ndryshme u është caktuar ky rol, duke rrezikuar potencialisht procesin e sinjalizimit, për shkak të mungesës së njohurive të tyre në këtë drejtim. Si mungesë e besueshmërisë tek zyrtari që pranon dhe trajton rastet e sinjalizimit u theksua se më shumë informacione konfidenciale për sinjalizim pranohen nga OJQ-të dhe media, sesa brenda vetë institucioneve. Kjo nënkupton se abuzimet vazhdojnë të ndodhin, por mungesa e besimit tek institucionet përkatëse mbetet.

Poashtu u shprehën shqetësime të mëtejshme lidhur me ruajtjen e dosjeve nga zyrtari sinjalizimit nga momenti kur ai lirohet nga detyra deri në emërimin e dikujt tjetër. Duke pasur parasysh rëndësinë e ruajtjes së konfidencialitetit të sinjalizuesve, u theksua se ekziston rreziku që këto të dhëna të bien në duar të pasigurta dhe të keqpërdoren, veçanërisht në institucionet ku ka ndikim politik në emërimin e zyrtarëve. Në këtë drejtim, u diskutua për rrezikun e mundshëm të ndërrimit të stafit politik në institucione të caktuara, ku të dhënat konfidenciale mund të keqpërdoren për inate politike.

Fokus grupi përmendi edhe rastet kur institucionet vonojnë emërimin e një zyrtari të sinjalizimit, nuk e informojnë stafin kur zyrtari largohet nga detyra e tij ose kur emërohet një zyrtar i ri. Kjo krijon një situatë ku rastet gabimisht mund t'u raportohen zyrtarëve të cilët nuk janë më përgjegjës për sinjalizimin.

Si një tjetër pengesë për zbatimin e këtij ligji u theksua mungesa e informacionit për publikun apo stafin për procedurën e sinjalizimit apo se si mbrohen sinjalizuesit sipas këtij ligji. Prandaj, u propozua që APK-ja gjithashtu të përgatisë promo të shkurtra informative për sinjalizimin, të cilat më pas do të mund të shpërndareshin përmes televizionit dhe ueb faqeve të institucioneve publike.

Një shqetësim tjetër i ngritur ishte se KGJK-ja nuk ka asnjë rast sinjalizimi, duke pasur parasysh faktin se shumë raste që kanë të bëjnë me gjykatat raportohen në OJQ dhe media. Ky shqetësim vjen nga fakti se, nisur nga kjo, nënkuptohet se mund të ketë sjellje të pahijshme edhe brenda gjyqësorit, por nuk raportohet brenda institucionit.

Siç vërehet, shumica e këtyre sfidave pasqyrojnë frikën e hakmarrjes nga punëdhënësi. Lidhur me këtë, është përmendur një tjetër rast sinjalizimi, ku është përfshirë kryeministri Albin Kurti. Ky

rast ka të bëjë me një zyrtar publik, i cili është shkarkuar për shkak të dyshimeve të tij për parregullsi në MINT lidhur me procedurat e blerjes së rezervave shtetërore.<sup>35</sup>

Këta shembuj u përmendën për të ilustruar se si hakmarrja mund të dërgojë një mesazh kërcënues për sinjalizuesit dhe t'i dekurajojë ata të raportojnë shkeljeve. Për më tepër, kjo situatë tregon se zbatimi i Ligjit për Mbrojtjen e Sinjalizuesve para së gjithash kërkon vullnet politik.

## 6. Gjetjet kyçe dhe përfundimet

Gjatë këtij hulumtimi përmes analizës sasiore të të dhënave të mbledhura nga raportet vjetore të APK-së, IKD ka identifikuar një rritje nga viti në vit të rasteve të sinjalizimit të jashtëm. Megjithatë, sinjalizimet e brendshme japin një pamje të ndryshme. Raportet vjetore tregojnë një rënie të rasteve të raportuara nga viti 2020 deri në vitin 2021. Megjithatë, nuk mund të themi se numri i lartë i rasteve të sinjalizimit në vitin 2020 (146 raste) reflekton një trend pozitiv të sinjalizimit në të gjitha institucionet. Kjo për shkak se afërsisht 93% e këtyre rasteve, ose 136 raste, kanë qenë sinjalizime brenda një institucioni të vetëm (QKUK), ndërsa në vitet në vijim nuk është raportuar asnjë rast sinjalizimi nga ky institucion. Ndërkohë, të dhënat e 2022 dhe 2023 për sinjalizimin e brendshëm tregojnë se ka filluar të rritet numri i rasteve.

Po ashtu, IKD gjen se ka pasur shkelje të Ligjit për Mbrojtjen e Sinjalizuesve. Sidomos në lidhje me detyrimet që përcaktohen për institucionet publike, subjektet private si dhe rregullatorë sipas fushës ku bëhet sinjalizimi. Në bazë të ligjit, këto institucione duhet të përgatisin një raport vjetor për rastet e sinjalizimit për vitin paraprak dhe këtë raport duhet t'ia dorëzojnë APK-së, e cila më pas përgatit një raport vjetor dhe e publikon<sup>36</sup>. Por në bazë të hulumtimit dhe diskutimit në fokus grup rezultoi se ky detyrim nuk ndodh, siç e parashikon ligji. Pra, ka pasur institucione që nuk raportojnë në APK siç e kërkon ligji. Raporti vjetor i APK-së për vitin 2022, thekson se nga 180 institucione publike për të cilat Agjencia ka informacion për zyrtarin përgjegjës të caktuar për sinjalizim, 51 institucione publike nuk e kanë dorëzuar raportin e sinjalizimit për gjashtëmuorin e parë të APK-së, ndërsa 129 institucione tjera e kanë dorëzuar raportin.

Gjithashtu, mungon informacioni i nevojshëm për rezultatin e rasteve në raportin që APK-ja publikon çdo vit. Rregullorja për Përcaktimin e Procedurës për Pranimin dhe Trajtimin e Rasteve të Sinjalizimit përcakton qartë se raportet duhet të përbëhen nga numri i raportimit ose zbulimit të interesit publik, madje edhe veprimet e ndërmarra në lidhje me ato raporte ose zbulime.<sup>37</sup> Ndërsa, ajo që shihet në raportimin për vitet 2022 – 2023, konstatohet mungesa e raportimit të duhur të veprimeve të ndërmarra nga autoritetet.

---

<sup>35</sup> Betimi për Drejtësi, sinjalizuesi i MINT i shkarkuar, thotë se kjo është hak për çështjen e rezervave shtetërore, <https://betimiperdrejtesi.com/largohet-nga-puna-sinjalizuesi-i-mint-it-thote-se-kjo-eshte-hak-per-ceshtjen-e-rezervave-shteterore/>, qasur për herë të fundit më 12 gusht 2024.

<sup>36</sup> Rregullore (QRK) - Nr. 03/ 2021 Për Përcaktimin e Procedurës për Pranimin dhe Trajtimin e Rasteve të Sinjalizimit; Neni 16.

<sup>37</sup> Po aty.



Në raportin e APK-së nuk jepet informacioni i duhur në lidhje me afatin kohor të trajtimit të rasteve. Prandaj, është e pamundur të identifikohet nëse ka pasur vonesa, apo kërkesa për zgjatjen e afatit të trajtimit të hetimit administrativ të denoncimit. IKD ka arritur të marrë një përgjigje zyrtare nga KPK, ku thuhet se sipas Ligjit Nr. 06/L-085 për Mbrojtjen e Sinjalizuesve dhe Rregullores (QRK) për përcaktimin e procedurës për pranimin dhe trajtimin e rasteve të sinjalizimit, procedura e hetimit administrativ e sinjalizimit përfundon brenda afatit prej 90 ditësh, duke përfshirë edhe dhënien e vendimit për rastin brenda këtij afati.<sup>38</sup>

Raportet vjetore të APK-së tregojnë një trend shqetësues, ku disa raste të sinjalizimit u referohen institucioneve nga ku ka nisur rasti, për trajtim të brendshëm. Kjo shfaq nevojën për mekanizma më të fuqishëm të raportimit të brendshëm brenda këtyre institucioneve. Duke promovuar rëndësinë e raportimeve të brendshme të sinjalizimit, këto institucione mund të krijojnë një hapësirë të sigurt për punonjësit për të ngritur shqetësimet e brendshme, duke parandaluar potencialisht nevojën për hapa të mëtejshëm jashtë atij institucioni.

Për më tepër, në disa raste, bazuar në raportet vjetore të APK-së, është vërejtur se rastet e paraqitura për raportim nuk ishin të plota ose të paqarta, gjë që tregon mungesën e ndërgjegjësimit dhe informacionit të nevojshëm për sinjalizuesit. Për më tepër, raportet vjetore të APK-së zbulojnë një boshllëk në raportimin nga institucionet lokale. Të gjitha rastet e raportuara përfshijnë institucionet qendrore. Kjo sugjeron mungesën e një fushate gjithëpërfshirëse për të inkurajuar sinjalizimin nga autoritetet lokale.

Në përgjithësi, institucionet publike nuk i japin rëndësinë e duhur sinjalizimit. Ka pasur raste kur është e paqartë se kush është zyrtari i caktuar për marrjen dhe trajtimin e raporteve të sinjalizimit, madje edhe raste kur punonjësit brenda një institucioni të caktuar nuk janë në dijeni se kush është zyrtari i caktuar për sinjalizim. Ndërkohë, u konstatua se ka institucione që i japin rëndësinë e duhur sinjalizimit, marrin më shumë sinjalizime dhe brenda këtyre institucioneve nuk ndërmerren veprime hakmarrëse ndaj sinjalizuesve.

## 7. Rekomandimet

1. APK duhet të respektojë ligjin për mbrojtjen e sinjalizuesve në lidhje me detyrimet e saj për raportimin e trajtimit të rasteve të sinjalizimit, apo mbikëqyrjen dhe kërkimin e raporteve për sinjalizimin e brendshëm nga institucionet e tjera.
2. APK të përmirësojë formën e raportimit të trajtimit të rasteve të denoncimit, në mënyrë që të sigurojë një pasqyrë të plotë të të dhënave të çdo viti.
3. APK të rrisë transparencën duke dhënë të dhëna të plota dhe të sakta për sa i përket veprimeve të ndërmarra për çdo rast.
4. APK duhet të përfshijë në raport edhe afatin kohor të saktë të trajtimit të rasteve.

---

<sup>38</sup> Përgjigje në kërkesën për informata të KLI drejtuar APK, 14 qershor 2024.

5. Të forcohet sinjalizimi i brendshëm si hap i parë për sinjalizuesit dhe shmangia e mundësisë së shmangies së procedurës së rregullt.
6. Rritja e ndërgjegjësimit për rëndësinë dhe mundësitë e sinjalizimit, veçanërisht në institucionet lokale.
7. Përmbledhja e një analize të detajuar në lidhje me mundësitë e APK-së për hetimin e rasteve të sinjalizimit, tregon se, ose duhet të vendoset se APK ka autoritetin në këto raste, ose duhet t'i drejtohet Ministrisë së Drejtësisë me një kërkesë për të ndryshuar Ligji.
8. Institucionet të njoftojnë APK-në për çdo shkarkim/emërim të zyrtarit përgjegjës për sinjalizim.
9. Interesi publik duhet të ketë përparësi ndaj formaliteteve të procedurës së rasteve.
10. Në varësi të numrit të stafit dhe numrit të rasteve të pranuar, angazhimi i zyrtarëve përgjegjës në trajtimin e rasteve të sinjalizimit duhet të reflektohet në reduktimin e detyrave të tyre bazë të punës lidhur me procedimin e rasteve të sinjalizimit. .
11. Duhet të ketë trajnime më të avancuara dhe të shpeshta për zyrtarët që pranojnë dhe trajtojnë rastet e sinjalizimit.
12. Të shtohen inspektimet lidhur me detyrimin ligjor për caktimin e një zyrtari përgjegjës për sinjalizim.
13. Krijimi i një grupi punues për ndërmarrjen e aktiviteteve të sinjalizimit në institucionet lokale.